



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË FONDIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mirlinda Beqiri dhe Alban Beka udhëheqës ekipi si dhe anëtareve Neslihane Mati, dhe Arnisa Aliu nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	18
Shtojca II- Letër Konfirmimi.....	21

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat financiare vjetore ishin përgatitur në harmoni me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka vendosur një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit por që ende nevojiten veprime shtesë që kërkojnë përmirësime të mëtejme, në menaxhimin e subvencioneve për trajtime mjekësore dhe menaxhimin e prokurimeve. Po ashtu, dobësi kishte edhe në menaxhimin e pasurive sa i përket regjistrimit të tyre në sistemet e SIMFK-së dhe e-Pasurisë.

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak tregon që prej tre rekomandimeve të dhëna, një ishte në proces të zbatimit, një nuk ishte adresuar, dhe një rekomandim është konsideruar si i mbyllur.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të FSSh-së gjatë gjithë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Çështjet kyçe të auditimit

Vlera e obligimeve të papaguara për trajtime mjekësore jashtë institucioneve shëndetësore publike (TMJISHP), në fund të vitit 2019 kishte arritur në 10,491,883€.

Niveli i lartë i obligimeve ishte rezultat i mungesës së mjeteve financiare në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Drejtuesit e FSSH-së kane bërë kërkesa të vazhdueshme në Ministri të Financave për rritje të buxhetit në mënyrë që të realizohen obligimet por këto kërkesa nuk janë marr parasysh në nivelin e kërkuar.

Sipas nenit 4 të UA 03/2017 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike "Çdo qytetar dhe banor/shtetas i Republikës së Kosovës ka të drejtë të aplikoj në programin për TMJISHP kur shërbimi i caktuar shëndetësor nuk ofrohet në institucionet publike shëndetësore, në pajtim me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ". Komisionet mjekësore në QKUK lëshojnë mendime konsolidare për pacientët që duhet trajtuar jashtë institucioneve publike, kurse Bordi si organ i pavarur për TMJISHP aprovon kërkesat dhe obligon drejtorin e FSSH të nxjerr vendim për Kompensim. Si rrjedhojë e këtij procesi FSSH obligohet të nxjerrë vendime për kompensim edhe në mungesë të fondeve, duke rritur vlerën e obligimeve. Nën këto parakushte Ministria e Financave duhet ta mbështesë FSSH me buxhet për të shlyer obligimet dhe parandaluar rritjen e tyre.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Drejtori i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Bordi Drejtues është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar mangësitë.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë, pagesa e shtesave në paga sipas Ligjit për Sigurime Shëndetësore, menaxhimi i prokurimeve me fokus në procesin e vlerësimit dhe arsyetimi i mjeteve nga subvencionet si dhe vazhdimi i procesit të barazimeve. Po ashtu, menaxhimi i pasurive nuk ishte në nivelin e kërkuar pasi që pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019
Burimet e Fondeve:	8,697,583	9,544,257	9,408,130	99 %
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,797,583	9,484,257	9,376,126	99 %
Të hyrat nga AKP	900,000	60,000	32,004	53%

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 846,674€. Kjo rritje është rezultat i rritjes nga Granti i Qeverisë. Në anën tjetër kishte zvogëlim nga të hyrat e AKP-së me vendime të Qeverisë si pasojë e mos shpenzimit të buxhetit. Këto ndryshime buxhetore kanë ndodhur me Vendime të Qeverisë Nr. 01/113 të datës 05.11.2019 dhe Nr.01/112 të datës 17.12.2019.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimi 2019
Shpenzimet e fondeve sipas kat. ekonomike:	8,697,583	9,544,257	9,408,130	99 %
Pagat dhe Mëditjet	641,286	357,960	357,960	100 %
Mallrat dhe Shërbimet	1,060,137	360,137	266,169	74 %
Shërbimet komunale	66,160	36,160	22,218	61 %
Subvencionet dhe Transferet	6,000,000	8,700,000	8,699,979	100 %
Investimet Kapitale	930,000	90,000	61,804	69 %

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 283,326€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore si pasojë e mos plotësimit të pozitive sipas Ligjit të Buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 700,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore si pasojë e mos shpenzimit të buxhetit. Sipas zyrtareve përgjegjës të organizatës mos shpenzimi i mjeteve sipas buxhetit fillestar ka ndodh për shkak të mos shtrirjes së FSSH-së në zyrat rajonale;
- Buxheti final për shërbime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 30,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,700,000€. Ndryshimet kane ndodhur me vendim të Qeverisë për pagesën e obligimeve për trajtime shëndetësore jashtë institucioneve shëndetësore publike; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 840,000€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore si pasojë e mos shpenzimit të buxhetit për projektet e planifikuara sipas buxhetit fillestar.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 357,960€ i cili ishte realizuar 100%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 98 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 44. Sipas zyrtareve përgjegjës të organizatës mos plotësimi i vendeve të punës ka ndodh në mungesë të kushteve për shtrirjen e FSSH-së në zyrat rajonale. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 6 të rinj. Kemi testuar 11 mostra për teste substanciale në vlerë 6,860€, si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Aplikimi i shtesës për nëpunësit civil

Gjetja Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.11/126 të datës 26.05.2010 në pikën 1 thekson që "Të gjithë të kategorizuar si nëpunës civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës do të përfitojnë mjete financiare në baza mujore, në vlerë prej 30 euro bruto". Ligji për Sigurime Shëndetësore në nenin 27.3 thekson se "Të punësuarit në Fond nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës dhe statusi i tyre realizohet me akt nënligjor të propozuar nga Bordi Drejtues dhe të miratuar nga Qeveria.

Gjatë testimit të mostrave nga kategoria e pagave kemi vërejtur se 44 punonjës të FSSH kanë marr shtesën për shërbyes civil prej 30€ në muaj, përkundër që nuk janë nëpunës civil. Vlera totale për periudhën mars-dhjetor ishte 13,200€. Sipas zyrtarëve të FSSH-së shtesat realizohen nga Ministria e Administratës Publike dhe këta e kanë të pamundur që të bëjnë ndërhyrje.

Ndikimi Pagesa e shtesave për të punësuarit që nuk janë shërbyes civil përveç që është në kundërshtim me vendimin e qeverisë ka edhe ndikim financiar në buxhetin e FSSH-së.

Rekomandimi A1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë që janë marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e FSSH bëhet në përputhje me Ligjin e Punës.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 396,297€ (përfshirë edhe buxhetin për shpenzime komunale), prej tyre ishin shpenzuar 288,387€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet për qira, mirëmbajtje dhe sigurim fizik të ndërtesës si dhe shpenzime tjera. Kemi testuar nëntë (9) mostra për teste substanciale në vlerë 34,450€ si dhe katër (4) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Mos shfrytëzimi i të drejtës për të kërkuar informata sqaruese**Gjetja**

Sipas nenit 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik pika 3, "Lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate". Ne kemi vërejtur se:

- Te procedura e prokurimit "Përkthimi i dokumenteve zyrtare të FSSH-së" në kërkesat e bëra lidhur me përshtatshmërinë profesionale janë kërkuar të plotësohen tri³ kritere ndër to edhe "letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për përvojën e mëparshme të përkthyesit. OE fitues nuk kishte përmbushur në tërësi kërkesat pasi që rreth kriterit të lartë cekur ka bashkangjitur vetëm CV ose vërtetimet për interpret gjyqësor (këto kanë qenë kritere të veçanta). Komisioni për vlerësim të tenderëve dhe zyrtari i prokurimit nuk kanë kërkuar informacione shtesë nga OE dhe kanë vazhduar me procedurë duke nënshkruar kontratën pasi që oferta ka qenë më e lirë. Kontrata është nënshkruar me datë 24.06.2019 në vlerë prej 4,898€; dhe
- Te procedura e prokurimit "Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike të Objektivit të FSSH-së" është eliminuar OE⁴ për shkak se nuk ka ofruar referencë për menaxherin e projektit për punët e mëhershme menaxheriale. Sipas menaxherit të prokurimit OE ka prezantuar një letër rekomandim por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme. FSSH nuk kishte kërkuar informacione apo dokumente për sqarim të tenderit. Komisioni nuk ishte në dijeni se mund të kërkojnë informacione apo dokumente shtesë.

Ndikimi

Mos respektimi i dispozitave ligjore, rritë rrezikun e nënshkrimit të kontratave me operatorë të pa përgjegjshëm. Kjo dëmton transparencën e procesit dhe mundësinë e diskriminimit të operatorëve tjerë konkurrues gjithashtu mund t'i shkaktoj humbje financiare Fondit.

Rekomandimi A2

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë që komisioni për vlerësimin e tenderëve bënë ekzaminimin e plotë të ofertave, dhe aty ku paraqitet nevoja për sqarime tjera nga OE, t'i informoj duke siguruar informatat e nevojshme brenda kufijve të lejuar.

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione në 2019 ishte 8,700,000€, prej tyre ishin shpenzuar 8,699,979€. Ato kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 3,351,852€ si dhe 100 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Mos arsyetim i mjeteve për trajtimet mjekësore të subvencionuara

Neni 5.5 i UA 03/2017 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP) thekson se Drejtori i Fondit lëshon një fletëzotim për mbulim të shpenzimeve për trajtimin mjekësor. Në fletëzotimin e lëshuar nga FSSH theksohet se shpenzimi mbulohet në momentin e përfundimit të procedurave administrative në bazë të fletë lëshimit dhe të faturës nga institucioni. Ne identifikuam se:

- Në 25 raste, si raste urgjente nuk janë ofruar dëshmi (faturë apo fletëlëshim) për pagesat e realizuara për trajtimet për rastet urgjente. Sipas menaxhmentit këto mangësi vijnë nga pamundësia për të siguruar këto dokumente nga institucionet shëndetësore jashtë vendit, dhe mangësitë e UA; dhe
- Në 50 raste, jo urgjente nuk janë ofruar dëshmi të trajtimeve e që kjo është në kundërshtim me kërkesat e vendimit që i është lëshuar palës, ku theksohet se pala obligohet që pas trajtimit, të sjellë faturat e shpenzimeve të mjekimit nga institucioni përkatës. Sipas zyrtarëve të Fondit palët nuk kanë dërguar faturat e shpenzimeve pas trajtimit.

Ndikimi

Mungesa e një strategjie të qëndrueshme dhe të qartë për arsyetimin e plotë të shpenzimeve për TMJIPSH shkakton vështirësi në menaxhimin e shpenzimeve dhe mund të krijoj mundësinë që të ndodhin pagesa të parregullta apo pagesa për shërbimet që nuk janë pranuar.

Rekomandimi B1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojnë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke i respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara nga Fondi.

³ “Për përkthyesit, • CV, • kopjen e diplomës universitare- gjuhë angleze ose në vend të diplomës, të vlefshme janë edhe aktvendimet apo vërtetimet valide për interpret gjyqësor - kopje • letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për përvojën e mëparshme të përkthyesit për përkthim anglisht - shqip dhe anasjelltas - kopje.

⁴ Oferta e OE të eliminuar ishte 12,420€, ndërsa kontrata e nënshkruar me OE ishte 12,720€ apo 300€ më e madhe.

Çështja C1 - Harmonizimi me Spitalet në të cilat kryhen shërbimet për TMJIPSH

Gjetja Paragrafi 5 i nenit 12 të Udhëzimit Administrativ UA nr.03/2017 për TMJISHP obligon që divizioni për TMJISHP të mbajë komunikim të rregullt me institucionet ku trajtohen pacientët të cilët subvencionohen, dhe në baza tre mujore, të siguroj informacion për statusin e trajtimit të tyre.

Ne kemi vërejtur progres në këtë fushë pasi që Drejtori i Fondit ka themeluar komisionin për barazime financiare me datë 28.02.2019. Deri në fund të vitit 2019 nga 274 institucionet janë kryer barazimet në 13 prej tyre e ku janë identifikuar mjete të lira në vlerë prej 383,222€⁵. Barazimet kishin filluar me institucionet me të cilat kishin më së shumti trajtime mjekësore dhe komisioni është ende në proces të kryerjes së barazimeve.

Ndikimi Barazimet e realizuara ndikojnë direkt në identifikimin e mjeteve të lira duke mundësuar trajtimin e pacientëve në pritje dhe rrjedhimisht edhe në uljen e obligimeve.

Rekomandimi C1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë vazhdimin e procesit të barazimeve – harmonizimeve me një intensitet të shtuar me qëllim që të identifikohen mjetet e lira dhe rritet mundësia për trajtimin e pacientëve në pritje.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 90,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 61,804€. Ato kanë të bëjnë me blerjen e veturës dhe punimin e projekt-dizajnit për ndërtesën e FSSh. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 61,804€, si dhe tre (3) mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të e vitit 2019 ishte 140,645€, ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 94,398€. Stoqet në fund vit ishin 3,353€. Kemi testuar tetë (8) mostra për teste substanciale në vlerë 125,342€, si dhe teste të pajtueshmërisë.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive.

⁵ Menaxhmenti kishte vendosur që mjetet e lira të shfrytëzohen për trajtimin e pacientëve që janë në listën e pritjeve për pagesë.

Çështja A3 – Dobësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja Sipas nenit 6.3 të Rregullores – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Ne identifikuam se pasuritë kapitale në vlerë prej 56,571⁶€ nuk ishin regjistruar në SIMFK (pasuria e blerë në vitin 2019 nga FSSH në vlerë prej 31,304€ si dhe pasuria në vlerë prej 25,267€ nuk ishte transferuar nga Ministria e Shëndetësisë -MSH). Po ashtu, edhe pasuritë nën 1,000€ të blera gjatë vitit 2019 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Megjithatë, FSSH kishte të evidentuar të gjitha pasuritë në regjistrat e brendshëm dhe vlera e prezantuar në PFV ishte bazuar në këta regjistra.

Përkundër përpjekjeve nga zyrtarët e FSSH për transferimin e pasurive nga MSh kjo nuk kishte ndodhur deri në publikimin e PFV.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë i pasurive në SIMFK dhe në sistemin e e-pasurisë përveç që është në kundërshtim me rregulloren pamundëson që Ministria e Financave të ketë informata rreth pasurive të FSSH dhe ndikon në menaxhimin e tyre.

Rekomandimi A3 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrat përkatës, në mënyrë që të ketë një menaxhim dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 10,508,520€ prej tyre me afat për pagese me pak se 30 dite ishin 686,571€ ndërsa 9,821,949€ më shumë se 30 ditë. Pjesa me e madhe e këtyre detyrimeve (99.84%) i takojnë trajtimeve shëndetësore jashtë vendit. Kemi testuar 100 mostra në vlerë 4,411,473€.

⁶ Sipas PFV të FSSH-së vlera neto e pasurive mbi 1,000€ ishte 140,645€ kurse sipas Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës vlera e pasurive mbi 1,000€ për FSSH ishte 84,074€.

2.3.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2019 të shpalosura në PFV ishin vlerësuar rreth 115,546€.

2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Bazuar në informatat e pranuar nga FSSH vlera e detyrimeve kontraktuale ishte 948,974€. Këto detyrime kontraktuale kanë të bëjnë për projektin për furnizim me pajisje të IT-së dhe për qiranë e objektit të FSSH.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtar të stafit, i cili njëherit është edhe Drejtor i NjAB. NjAB-i, kishte hartuar planin vjetor të punës ku ishin planifikuar 4 auditime, të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit.

Raportet e auditimit të brendshëm kane mbuluar fushën e trajtimeve jashtë vendit, menaxhimin e shpenzimeve, menaxhimin e personelit dhe menaxhimin e shërbimit farmaceutik. Nga raportet ishin dhënë 9 rekomandime, prej tyre 6 janë zbatuar dhe 3 ishin në proces të zbatimit.

NjAB kishte raportur në NJQH-AB për mënyrën se si funksionon NjAB në FSSH duke përfshirë këtu realizimin e raporteve, numrin e rekomandimeve të dhëna si dhe sa prej tyre janë implementuar.

Komiteti i Auditimit është themeluar me 11.09.2019 dhe deri në përfundim të vitit 2019 kishte mbajtur katër (4) takime ku kishin nxjerr konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit të NjAB-së.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Gjatë vitit 2018 Fondi ka funksionuar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Në raportin për PFV të vitit 2018 të Ministrisë së Shëndetësisë tre (3) rekomandime kanë pasur të bëjnë me FSSH. Në vitin 2019 FSSH është themeluar si organizate buxhetore dhe zbatimi i rekomandimeve ka kaluar tek menaxhmenti i FSSH.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, një rekomandim është në proces, një rekomandim nuk ishte adresuar dhe një rekomandim është konsideruar i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 3. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet menjëherë të krijojë një komision për të zbatuar një proces të harmonizimit që do të mbuloj të gjitha spitalet private, dhe se çdo fond që u paguhet këtyre spitaleve dhe që tejkalon shpenzimet aktuale të trajtimit, duhet të kthehet në MSh.	Drejtori i fondit ka themeluar komisionin për barazime financiare me datë 28.02.2019. Deri në fund të vitit 2019 janë kryer barazimet me 13 institucione ku kane dal mjete të lira 383,222€. Komisioni është ende në proces të kryerjes së barazimeve. Shih C1	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të krijoj mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke e respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara nga ministria.	Gjate testimit të pagesave edhe këtë vit kemi hasur në raste të njëjta. Shih B1	Rekomandim i pazbatuar
3	Obligimet e pa paguara	Ministri të siguroj se Bordi ekzekutiv i TMJISHP me rastin e aprovimit të kërkesave për trajtim të pacientëve, duhet të merr në konsiderim fondet buxhetore në dispozicion dhe të mos aprovoj kërkesa që krijojnë obligime për vitet vijuese.	Obligimet janë në nivel të lartë edhe këtë vit. Megjithatë kjo nuk varet nga FSSH. Shih tek çështjet kyçe	Rekomandim i mbyllur
Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Pagat dhe mëditjet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë që janë marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e Fondit bëhet në përputhje me Ligjin e Punës.		
2.	Mallra dhe Shërbime	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë që komisioni për vlerësimin e tenderëve bën ekzaminimin e plotë të ofertave, dhe aty ku		

		paraqitet nevoja për sqarime tjera nga OE, t'i informoj duke siguruar informatat e nevojshme brenda kufijve të lejuar.
3.	Subvencione dhe Transfere	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojnë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke i respektuar obligimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara nga Fondi.
4.	Subvencione dhe Transfere	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë vazhdimin e procesit të barazimeve – harmonizimeve me një intensitet të shtuar me qëllim që të identifikohen mjetet e lira dhe rritet mundësia për trajtimin e pacientëve në pritje.
5.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrat përkatës, në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II- Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor
Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Fatmir Plakiqi

Drejtori i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore,

Data: 29 korrik 2020, Prishtinë

